



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:111178

Datë: 21.04.2021

Numri i dokumentit: 02327576

PPP.nr.100/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh.Sh. nga fsh ..., komuna e Ferizajt, të cilin me autorizim e përfaqëson av Visar Musa nga Ferizaj, kundër debitorëve: Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Kryeministrit, për pagesën e kompensimit të dëmit, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, me datë 21.04.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorëve Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Kryeministrit, Avokatura Shtetërore, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.95/2020, të datës 06.02.2020, i lëshuar nga përmbartuesi privat Besnik Aliu nga Ferizaj dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.95/2020, i datës 06.02.2020.

II.REFUZOHET si i pabazuar propozimi për përmbartim i kreditorit Sh.Sh., i ushtruar kundër debitorëve Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Kryeministrit.

A r s y e t i m

Me urdhrin përmbartim P.nr.95/2020, të datës 06.02.2020, përmbartuesi privat Besnik H. Aliu nga Ferizaj, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit Shaip Shumolli, kundër debitorëve: Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Zyra e Kryeministrit, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore në Prishtinë,

për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në emër të kompensimit për dëmet e shkaktuara në sektorin e bujqësisë, në shumë të përgjithshme prej 2,549.40 euro, në bazë të vendimit Nr.01/58, të datës 24.07.2018, të nxjerrë nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe Raportit të Vlerësimit të Dëmeve, Nr.11/, i datës 31.05.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Komunën e Ferizajt, duke i përfshirë edhe shpenzimet e procedurës së përbarimit të cilat do të krijohen deri në përfundimin e procedurës së përbarimit, sipas TOAK-së, dhe ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit përfaqësuesi i debitorëve, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e të autorizuarit të debitorëve, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin dhe të mbetet në fuqi urdhëri për përbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përbarim dhe pretendimet në prapësim të përfaqësuesit të debitorëve dhe gjeti se prapësimi është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se vendimi i Zyrës së Kryeministrit nr.01/58, i datës 24.07.2018 dhe raporti i vlerësimit nga Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Ferizaj, i dt.31.05.2018, nuk janë dokumente përbaruese, gjykata këtë pretendim të përfaqësuesit të debitorëve e konsideron të bazuar sepse vendimi nr.01/58, i datës 24.07.2018, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument përbarues në bazë të dispozitave të nenit 21 dhe 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për arsye se vendimi i cekur më lart siq shihet nuk është i formës së prerë, i njëjti nuk e përmban kreditorin dhe debitorin, nuk e përmban objektin e përbarimit dhe mjetet e përbarimit, po ashtu nuk mund të kuptohet se cila është shuma e mjeteve që kërkohet nga kreditori dhe koha e përmbushjes së detyrimit, dhe duke i marrë për bazë faktet e cekura më lart, gjykata vlerëson se nuk mund të konstatohet se vendimi në fjalë a është përfundimtar apo jo. Po ashtu gjykata gjenë se vendimi nuk e përmban as klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, kusht ky i kërkuar në nenin 36, par 1, të LPP-së, në të cilën është përcaktuar shprehimisht se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*. Po ashtu vendimi nr. nr.01/58, i datës 24.07.2018, është i papërshtatshëm për përbarim dhe nuk i plotëson prezumimet e kërkuara në nenin 27, par 1, të LPP-së, për arsye se siq është përmendur

edhe më lart, vendimi në fjalë nuk e përmban kreditorin dhe debitorin, objektin e përmbartimit si dhe mjetet dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Përveq tjerash, gjykata konstaton se në rastin konkret nuk janë plotësuar edhe prezumimet apo kushtet e kërkuara në nenin 38, par 1, të LPP-së, që kanë të bëjnë me propozimin për përmbartim të kreditorit për arsye vendimi i përmendur nuk konsiderohet dokument përmbartues. Për më tepër në nenin 38, par 1, të LPP-së, është përcaktuar shprehimisht: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet të cilit duhet të kryet përmbartimi, objekti i përmbartimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*

Si përfundim, kjo gjykatë, duke i marrë parasysh të gjitha faktet e cekura më lart, gjeti se prapësimi i përfaqësuesit të debitorit është i bazuar dhe vendosi që prapësimin ta pranoj në tërësi si të bazuar, ta shfuqizoj urdhërin për përmbartim P.nr.95/2020, të datës 06.02.2020, dhe ta refuzoj në tërësi si të pabazuar propozimin e kreditorit të ushtruar kundër debitorëve.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.100/20, më datë 21.04.2021

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.